

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6316
E enjte, 20 maj 2021
çmimi 0.40 €

Gjermania ndihmon
Kosovën me 150 000 teste
për Covid-19 IFAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E PESTË STATUSORE NDAJ
ISH-KRERËVE TË UÇK-SË NË HAGË IFAQE 4-5

MBROJTJA KRITIKON PROKURORINË, KËRKON LIRIMIN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së



Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së ka kritikuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Avokatët e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqit kanë thënë se mbajtja e klientëve të tyre në


paraburgim derisa prokuroria ende vazhdon hetimet paraqet shkelje të drejtave të njeriut. Në konferencën e pestë statusore ata kanë vlerësuar se derisa prokuroria vazhdon hetimet dhe nuk është gati, klientët e tyre

duhet të lirohen nga paraburgimi përkohësisht. ZPS-ja ka deklaruar se po vazhdon nxjerrjen e materialeve, por mbrojtja është ankuar se nuk po u jep informacione të plota për dokumentet që po ua dorëzon

SALI BERISHËS DHE FAMILJES SË TIJ I NDALOHET HYRJA NË SHBA IFAQE 3



QEVERIA KURTI KAP "FSHESËN" PËR LARGIMIN E AMBASADORËVE POLITIKË IFAQE 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



MASAKRA NË BURGUN E DUBRAVËS, AKT I GJENOCIDIT! F.7

PËR TË SHPËTUAR NGA VDEKJA I THYEM DYERT E QELIVE TË BURGUT TË DUBRAVËS F.7

Shkruan: Sadik ZEQIRI, ish i burgosur në burgun e Dubravës



SI TË MBROHEMI NGA POPULIZMI? F.7

Shkruan: Faton ABDULLAHU



EKONOMI



EKONOMIA NË SHQIPËRI PO JEP SINJALE TË RIMËKËMBJES F.9

KPMSHCK-ja NË VITIN 2020 SHPENZOI 273 MIJË EURO F.9

SPORT

NIKA: PRISHTINA DO TË KETË PARAQITJE DINJITOZE NË LIGËN E KAMPIONËVE F.12

Franca lehtëson masat kundër koronavirusit

PARIS, 19 MAJ - Restorantet, dyqanet dhe hapësirat kulturore në të gjithë Francën rihapen sot, pas disa muajsh të mbyllura si pasojë e pandemisë së koronavirusit. Franca është vendi me numrin më të madh të të infektuarve në Evropë: mbi

5.9 milionë. Nga e mërkura, grupe me deri në gjashtë persona do të lejohen të hanë së bashku në tarracat e restoranteve. Po ashtu, ora policore do të nisë nga ora 21:00 dhe jo 19:00, siç ka qenë deri më tash. Numri i infeksioneve ditore

në Francë aktualisht është rreth 13 000. Shifra është më e ulët se kulmi i rasteve prej 40 000, i regjistruar muajin e kaluar. Fushata e vaksinimit në Francë, po ashtu, është përshpejtuar javët e fundit. Më shumë se 20 milionë

njerëz tani kanë marrë së paku një dozë të vaksinës, ndërsa gati nëntë milion i kanë marrë të dyja dozat. Qeveria kishte vendosur si synim për të vaksinuar 20 milionë njerëz me së paku një dozë deri në mes të majit. Sipas shifrave të Universitetit



“Johns Hopkins”, Franca ka regjistruar mbi 108 000 viktima nga koronavirusi.

Prokurorët në Nju-Jork nisin hetime kriminale kundër Trumpit

Uashington, 19 maj - Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm në Nju-Jork ka njoftuar se po heton Organizatën Trump “në cilësi kriminale”. Një zëdhënës i prokurorës Letitia James tha se hetimet në kompaninë e pronave të ish-presidentit amerikan Donald Trump “nuk janë më thjesht civile”.

James ka qenë duke shqyrtuar marrëdhëniet financiare të Trumpit edhe para se ai ta merrte detyrën e presidentit në janar të vitit 2017.

Trump, republikan, e mohon keqbërjen dhe thotë se hetimet nga një prokuror demokrat janë hakmarrje politike. “E kemi informuar Organizatën Trump se hetimet nuk janë më thjesht të natyrës civile”, ka thënë për BBC-në

zëdhënësi i Jamesit, Fabien Levy, duke mos dhënë detaje të tjera. Ai nuk tregoi se çfarë i ka shndërruar hetimet nga civile në kriminale dhe nëse vetë Trumpi është personalisht i përfshirë në ndonjë akuzë.

Rastet civile zakonisht kanë të bëjnë me dëmtimet e individëve dhe palëve private, përfshirë bizneset. Ligji penal zbatohet në rastet kur dëmi mendohet se prek shoqërinë në përgjithësi, përfshirë shtetin.

James i ka nisur hetimet civile në mars të vitit 2019, me pretendimet se Trumpi ka fryrë vlerën e aseteve të tij në banka kur ka kërkuar kredi dhe i ka nënvlerësuar ato për t'i ulur taksat e tij.



ShBA-ja dënon gjuhën e Erdoganit për Izraelin

Uashington, 19 maj - Shtetet e Bashkuara i dënuan komentet “antisemitike” të presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan për popullin hebre. Tensionet midis ushtrisë izraelite dhe militantëve palestinezë në Rripin e Gazës kanë arritur nivelin më të lartë qysh në vitin 2014.

Në një deklaratë të lëshuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit thuhet se “gjuha antisemitike nuk ka vend askund”. “Shtetet e Bashkuara janë thellësisht të përkushtuara për ta luftuar antisemitizmin në të gjitha format e tij”, ka theksuar Departamenti Amerikan i



Shtetit, duke i bërë thirrje Turqisë që t'i bashkohet ShBA-së në përpjekjet për t'i

dhënë fund konfliktit midis izraelitëve dhe palestinezëve. Erdogan për kohë të gjatë ka

shprehur mbështetje për palestinezët, edhe pse Turqia është ndër vendet e pakta me shumicë myslimane që ka marrëdhënie afatgjata me Izraelin.

Dënimi nga ShBA-ja erdhi pasi Erdogani e akuzoi Izraelin për “terrorizëm” kundër palestinezëve, duke thënë se kjo “është në natyrën e tij”. “Ata janë vrasës deri në atë pikë që vrasin fëmijë 5 ose 6 vjeç. Ata kënaqen vetëm duke thithur gjakun e tyre”, ka deklaruar Erdogan.

Më herët, Erdogani ka pohuar se edhe presidenti amerikan Joe Biden “ka duar të përgjakshme” për shkak të

mbështetjes së ShBA-së për Izraelin.

Tensionet në Lindjen e Mesme janë rritur qëkur Izraeli, më 10 maj, ka filluar një fushatë ajrore në Gaza, pasi militantët e Hamasit, që kontrollojnë territorin, kanë hedhur raketa në drejtim të Izraelit.

Dhuna ka pasuar disa ditë trazira rreth kompleksit të Xhamisë Al-Aqsa në Jerusalemin Lindor.

Zyrtarët shëndetësorë në Gaza thonë se 217 palestinezë, përfshirë 63 fëmijë, janë vrarë në sulmet izraelite dhe më shumë se 1 400 janë plagosur.

Ukraina shkarkon ministrin e tretë të Shëndetësisë, shkak pandemia

KIEV, 19 MAJ - Parlamenti i Ukrainës ka votuar për shkarkimin e ministrit të Shëndetësisë, Maksym Stepanov, për shkak të trajtimit të pandemisë së koronavirusit.

Ligjvënësit votuan me 292 vota për dhe një kundër shkarkimit të Stepanovit.

Ky është ministri i tretë i Shëndetësisë që shkarkohet, që nga fillimi i pandemisë, pranverën e vitit të kaluar. Shkarkimin e kërkoi kryeministri Denys Shmyhal.

Me më shumë se 2 milionë infeksione të regjistruara me koronavirus dhe mbi 48 000

viktima, Ukraina është ndër vendet më të goditura në Evropë nga pandemia. Ky vend, po ashtu, mbetet prapa në fushatën e vaksinimit.

Deri më 18 maj rreth 950 000 ukrainas kanë marrë dozën e parë të vaksinës. Të martën Parlamenti i

Ukrainës miratoi edhe dorëheqjen e ministrit të Ekonomisë, Ihor Petrashko, dhe të Infrastrukturës, Vladyslav Kryklyi.

Ata nuk i zbuluan arsyet e dorëheqjes. Ekonomia e Ukrainës është tkurrur për 2 për qind në çerekun e parë të vitit 2021.



Kurti në Bruksel kërkon liberalizimin e vizave

BRUKSEL, 19 MAJ (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, me ftesë të përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Çështje të Sigurisë, mori pjesë në darkën tradicionale me liderët e shteteve të Ballkanit Perëndimor. Para darkës së përbashkët kryeministri Kurti u takua me përfaqësuesin e lartë, Borrell, gjatë të cilit takim ai konfirmoi interesimin dhe gatishmërinë e Republikës së Kosovës për të përparuar drejt integritimit evropian.

Në një adresim të shkurtër para fillimit të darkës, kryeministri Kurti tha se Bashkimi Evropian është projekti më i rëndësishëm i

paqes dhe progresit që nga Lufta e Dytë Botërore dhe se ai duhet të mbrohet me çdo kusht. Ai shtoi se me miqtë dhe kolegët tanë në Bruksel duhet të diskutojmë për zbatimin e reformave në vendin tonë dhe, në anën tjetër, për nevojën për njohjen e Republikës së Kosovës nga pesë shtetet mosnjohëse, ashtu që perspektiva evropiane të kthehet në integrim evropian. Kurse pas darkës, kryeministri Kurti në deklarimin e tij para mediave tha se theksi i diskutimit ishte te raporti i Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian dhe nevojën e afateve për avancimin sa më të shpejtë të

të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt integritimit evropian. Kurse theksi i tij ishte te nevojja për liberalizim të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës dhe investimeve në ekonomi, të cilat e zvogëlojnë emigrimin dhe e rrisin punësimin posaçërisht të rinjve. Darka tradicionale me liderët e shteteve të Ballkanit Perëndimor bëhet nën organizimin e Përfaqësuesit të Lartë të BE-së, dhe shërben si mundësi e mirë për diskutim të përbashkët mbi zhvillimet në rajon, bashkëpunimin bilateral me BE-në dhe rrugën e Ballkanit Perëndimor drejt integritimit evropian.



Gjermania ndihmon Kosovën me 150 000 teste për Covid-19



PRISHTINË, 19 MAJ (ER) - Gjermania ka dorëzuar një donacion të seteve të testimit për Covid-19 për ta fuqizuar më tej përgjigjen ndaj pandemisë në Kosovë.

Dërgesa e 150 000 testeve për Covid-19 ka një vlerë mbi 600 000 euro.

Ky donacion do t'i shërbejë sistemit shëndetësor në Kosovë për ta luftuar përhapjen e Covid-19. Me këtë rast, ambasadori gjerman në Kosovë, Jorn Rohde, ka thënë se do të vazhdojnë të qëndrojnë së bashku në luftën kundër pandemisë. "Solidariteti ynë mbetet elementi kyç në këtë përpjekje. Gëzohem që

donacioni ynë do të ndihmojë në forcimin e kapaciteteve të sistemit shëndetësor të Kosovës në luftën kundër pandemisë. Zbulimi i rasteve të infektimit me Covid 19 dhe parandalimi i përhapjes së mëtejshme të virusit mbetet qëllim kryesor. Virusi vazhdon të jetë kërcënim dhe është ende gjerësisht i pranishëm në shoqëritë tona. Edhe përkundër rënies së numrit të rasteve të reja ditore në Kosovë e gjetiu, ne duhet edhe më tej t'u përmbahemi udhëzimeve higjienike në mënyrë që t'i mbrojmë personat e rrezikuar. Gjermania mbetet krah

Kosovës dhe vazhdon ta mbështesë luftën e qeverisë kundër Covid-19", ka thënë Rohde.

Ndërkaq ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka thënë se është nder ta pranojnë furnizimin prej 150 000 seteve për testim Covid-19 nga partneri ynë, Gjermania. "Shifrat ditore të infektiveve me Covid-19, ndonëse janë normalizuar, ato ende paraqesin një sfidë reale për ne dhe kontinentin, ashtu që shkëmbimi i përvojave për menaxhimin e situatës, si dhe mbështetja e Gjermanisë për Kosovën, janë shumë të rëndësishme", ka thënë Vitia.

Sali Berishës dhe familjes së tij i ndalohej hyrja në ShBA

TIRANË, 19 MAJ - Departamenti i Shtetit i ShBA-së u ka ndaluar hyrjen në territorin amerikan ish-presidentit dhe ish-kryeministrit të Shqipërisë, Sali Berisha dhe anëtarëve të familjes së tij të ngushtë për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion të gjerë. Në deklaratën e sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, thuhet se Berisha, në cilësinë e tij zyrtare, në veçanti si kryeministër i Shqipërisë, ishte i përfshirë në veprime korruptive, të tilla si shpërdorim i fondeve publike dhe ndërhyrje në proceset publike.

Sipas DASH-it, ish-kryeministri shqiptar ka përdorur pushtetin e tij për përfitimet dhe për t'i pasuruar aleatët e tij politikë dhe anëtarët e familjes së tij. Rrjedhimisht, u është ndaluar

hyrja në ShBA, Berishës, bashkëshortes së tij, Liri Berisha, djalit të tij, Shkelzen Berisha dhe vajzës, Argita Berisha Malltezi. "Këta individë nuk janë të përshtatshëm për të udhëtuar në Shtetet e Bashkuara", thuhet në deklaratë.

Shtetet e Bashkuara e arsyetojnë vendimin me faktin se i njëjti është në vazhden e riafirmimit të përkrahjes së ShBA-së për reformat kryesore politike dhe institucionet demokratike të Shqipërisë. "Me shpalljen e këtij vendimi unë po rikonfirmoj nevojën për llogaridhënie dhe transparencë në institucione dhe zyrtarëve publikë të Shqipërisë", thuhet në deklaratën e Blinken.

Shtetet e Bashkuara theksojnë gjithashtu se në kurriz të hetimeve të pavarura, Berisha



përmes retorikës së tij ka treguar se është i gatshëm ta mbrojë veten, anëtarët e familjes dhe aleatët e tij. Për vendimin e DASH-it, zëvendëskryeministri i Shqipërisë, Erion Braçe, reagoi me anë të një postimi në "Facebook", duke kujtuar "ata që vdiqën për

korupsionin e familjes dhe viktimat nga shpërthimi i Gërdecit". "ShBA-ja ia ndaloi hyrjen në vend familjes Berisha dhe familja e tij ndalohej për shkak të korupsionit dhe luftës ndaj demokracisë. Në këtë moment, të vetmit që më vijnë në mendje janë Ziver

Veizi, Faik Myrtaj, Hekuran Deda, Aleks Nika, të pushkatuar për ta mbrojtur korupsionin e familjes; 26 të vrarët nga shpërthimi i korupsionit të familjes në Gërdec", ka shkruar Braçe.

Sali Berisha ka qenë president i Shqipërisë nga viti 1992 deri më 1997. Më pas ai ka mbajtur edhe postin e kryeministrit nga viti 2005 deri më 2013.

Në "listën e zezë" të Departamentit Amerikan të Shtetit janë edhe disa ish-zyrtarë dhe figura politike të Shqipërisë. Ndalim të hyrjes në ShBA kanë ish-kryetari i bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, ish-kryeprokurori i Shqipërisë, Adriatik Llalla dhe kryetari i Partisë Social-Demokrate, Tom Doshi. Hyrja në ShBA këtyre personave u është ndaluar me arsyetimin e kryerjes së veprimeve korruptive.



ËSHTË MBAJTUR KONFERENCA E PESTË STATUSORE NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK-SË NË HAGË

Mbrojtja kritikon prokurorinë, kërkon lirimin e ish-krerëve të UÇK-së

Mbrojtja e ish-krerëve të UÇK-së ka kritikuar Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Avokatët e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqit kanë thënë se mbajtja e klientëve të tyre në paraburgim derisa prokuroria ende vazhdon hetimet paraqet shkelje të të drejtave të njeriut. Në konferencën e pestë statusore ata kanë vlerësuar se derisa prokuroria vazhdon hetimet dhe nuk është gati, klientët e tyre duhet të lirohen nga paraburgimi përkohësisht. ZPS-ja ka deklaruar se po vazhdon nxjerrjen e materialeve, por mbrojtja është ankuar se nuk po u jep informacione të plota për dokumentet që po ua dorëzon

Ajo ka treguar se prokuroria është në fazën kritike të këtij procesi dhe duke pasur parasysh problemet logjistike, ka dalë një punë që ka marrë burimet e tyre. “Jemi në fazën kritike të këtij procesi dhe parashikojmë të vazhdojmë deri në shtator të vitit 2021. Parashtrimi ynë do të mbetet siç ka qenë. Do t'i bëjmë parashtrimet lidhur me kohën e propozuar dhe dorëzimin e dosjes paraprake”, ka thënë ka thënë Lawson.

Këto deklarime të prokurorisë kanë nxjerrur reagimin e mbrojtjes.

Pierre Prosper, avokat i Hashim Thaçit, ka pyetur se përse janë në këtë konferencë kur prokuroria nuk është gati. “Përse jemi këtu nëse hetimet janë ende në vazhdim? Është një çështje që ka të bëjë me procesin e rregullt që lidhet me të drejtat e njeriut. Të akuzuarit kanë të drejtë të dinë pse

akuzohen dhe ne nuk e dimë. Cila është e ardhmja e parashikueshme për hetimet? Unë mund të flas për 2030-n, për këtë afat flasin? Ne duhet të dimë për çka po bëhet fjalë këtu. E keni parë se si i ndryshojnë datat”, ka thënë ai. Ai ka vlerësuar se derisa prokuroria vazhdon hetimet dhe nuk është gati, atëherë klientët e tyre duhet të lirohen nga paraburgimi përkohësisht. “Nga e drejta e tyre në një farë kuptimi për të pasur proces të drejtë të rregullt, janë privuar nga prezumimi i pafajësisë dhe prokuroria thotë është një përpjekje e madhe e zyrës, të gjitha klientët tanë rrinë në paraburgim larg familjes dhe ende nuk e dinë tërësinë e akuzave kundër tyre pikërisht pse prokuroria nuk është gati. Kjo shkel çdo normë të të drejtave të njeriut që lidhet me proceset e rregullta gjyqësore”, ka thënë ai.

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 MAJ - Mbrojtja e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) sërisht ka kërkuar lirimin e përkohshëm të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, të cilët gjenden në paraburgim në Hagë, pasi që Zyra e Prokurorit të Specializuar pranë Dhomave të Specializuara në Hagë ka deklaruar se hetimet ndaj të

akuzuarve ende po vazhdojnë. Avokatët e ish-krerëve të UÇK-së kanë vlerësuar se mbajtja në paraburgim e klientëve të tyre, pa e ditur saktë se për çfarë po akuzohen, është shkelje e të drejtave të njeriut.

Në konferencën e pestë statusore, mbajtur të mërkurën, prokurorja Claire Lawson ka deklaruar se hetimet për përmbushjen e mandatit të tyre po parashikojnë të vazhdojnë dhe se kjo nuk do të ndikojë për afatin e gjyqimit.

“Jemi të vetëdijshëm se do të na kërkohet autorizim gjyqësor dhe kur të dalin materiale shfajësuese, ato do t'i nënshtrohen nxjerrjes. Ne jemi në gjendje që materialet t'i paraqesim në mesin e tetorit 2021, ka një ndryshim nga parashikimi që kemi bërë përpara në shtator, siç thamë në parashtrimet e konferencës së fundit, në shtator ishte data më e hershme e parashikuar nga ne për t'i dhënë materialet në atë kohë”, ka thënë Lawson.



Edhe Ben Emmerson, avokat i Kadri Veselit, ka kritikuar afatet e përmendura nga prokuroria. Ai ka deklaruar se ishte prokuroria ajo që fillimisht kishte thënë se deri në shtator do të jetë gati që ta nisë gjyqin. Emmerson ka bërë me dije se me këtë ritëm mund të parashikohet që prokuroria të jetë gati për gjykim deri në mesin e vitit të ardhshëm. “U

akuzova që dhashë parashikim të rremë për kohëzgjatjen e fillimit të gjyqit, kur bëra kërkesë për lirim dhe për kohshëm ky ishte qëndrimi që kryetarja e tribunalit ua transmetoi vetë kryetarëve të shteteve në një takim evropian. Prokuroria është copë-copë në punën e saj dhe këta njerëz po mbahen në paraburgim pafundësisht derisa po përpiqet prokuroria të paraqes çështjen e saj”, ka thënë ai.

Emmerson ka deklaruar se Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk kanë juridiksion që t’i gjykojë veprat për të cilat akuzohen ish-krerët e UÇK-së. “Gjykata Kushtetuese e Serbisë e ka pranuar që njerëzit nuk mund të gjykohen për këto çështje sepse nuk kanë pasur juridiksion. Kjo gjykatë nuk ka juridiksion për ta gjykuar ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Veseli nuk ka asnjë akuzë të vetme që ka kryer një krim, që ka nxituar apo ndihmuar një ndërmarrje të tillë kriminale, nuk ka çështje kundër tij nëse sfida juridiksionale është e saktë. Mbase prokuroria mban diçka të fshehtë, shpreson se diçka do të dalë. Kërkoj të siguroheni që këta burra të mos mbahen në paraburgim dhe mocionet paraprake të trajtohen sa më shpejt që të jetë e mundur, ndryshe kjo gjykatë do t’i mbajë në paraburgim pa e mbajtur gjyqin”, ka thënë ai.

Kurse David Young, avokat i Rexhep Selimit, ka kritikuar prokurorinë për afatet kohore dhe përkthimin e dokumenteve. “Është absolutisht jo i kënaqshëm që të pranojmë një afat të tillë kohor siç u parashtrua nga prokuroria. Ne mund të themi se një prej statistikave më domethënëse është elementi i përkthimit me të cilin filluat këtë seancë gjyqësore. Duhet që dokumentet më të rëndësishme të përkthehen në shqip. Siç e thatë edhe në konferencën e fundit, është e

Prokuroria e Hagës kërkon masa mbrojtëse për 30 dëshmitarë në rastin e krerëve të UÇK-së

Para konferencës statusore, Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) ka dërguar parashtrësas e saj te Gjykatësi i Procedurës Paraprake ashtu siç ishte kërkuar në vendimin për caktimin e seancës së sotme. ZPS-ja me anë të një shkrese ka njoftuar se të gjitha materialet të cilat u janë prezantuar të akuzuarve gjatë intervistimit i janë zbuluar mbrojtjes qysh më 1 prill. Në këtë kontekst, Prokurori i Specializuar ka njoftuar se ka kërkuar masa mbrojtëse për rreth 30 dëshmitarë. “Të gjitha materialet e mbetura të treguara për secilin nga të akuzuarit gjatë intervistave të tyre për ZPS-në u zbuluan më 1 prill 2021. Për më tepër, më 28 prill 2021 ZPS-ja zbuloi një grup tjetër të materialeve të Rregullit 102 (1) (b). Që nga Konferenca e fundit e Statusit, SPO gjithashtu ka paraqitur kërkesat e tij të pesta dhe të

gjashta për masa mbrojtëse, që kanë të bëjnë, në mënyrë kumulative, me 30 dëshmitarë. Parashikohet që, në përputhje me orarin e përshkruar në Vendimin Kornizë, dhe siç është ndryshuar nga Vendimi i Kategorizimit, kërkesa të mëtejshme për masa mbrojtëse në lidhje me materialin e rregullit 102 (1) do të ngrihen”, thuhet në parashtrësen e Prokurorisë. Kështu, Zyra e Prokurorit të Specializuar tani e ka ndryshuar datën e mundshme për dërgimin e dosjes parajgyqësore. ZPS-ja në parashtrësen e saj ka thënë se këtë do ta ketë të mundur ta bëjë në tetor të këtij viti. “Në lidhje me materialin e rregullës 95 (4) (p. sh., paraqitje gjyqi paraprake dhe listat e dëshmitarëve dhe ekspozitave), duke vlerësuar shkallën në të cilën të gjitha

burimet në dispozicion pritet të zënë me përfundimin e punës për zbulim në muajt e ardhshëm, dhe faktin që zbulimi aktualisht parashikohet të vazhdojë deri në shtator 2021, SPO tani parashikon të jetë në gjendje ta paraqesë materialin e tij të rregullës 95 (4) deri në mes të tetorit 2021”, është thënë në parashtrësen e Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Në seancën që do të mbahet sot me fillim prej orës 11:45 pritet të ketë diskutime të forta me ZPS-në dhe mbrojtjen pasi që kjo e fundit në asnjë formë nuk e sheh të arsyeshme që gjykimi ndaj krerëve të UÇK-së të fillojë gjatë këtij viti. Ata si kohë të mundshme e shohin vetëm fundin e vitit të ardhshëm për arsyet e kohëzgjatjes së hetimeve që ata duhet të kryejnë në Kosovë për mbrojtjen e klientëve të tyre.

vështirë për ne, për mbrojtjen, sepse të akuzuarit kanë të drejtë t’i lexojnë pretendimet e prokurorisë për akuzat e tyre në gjuhën shqipe”, ka thënë ai.

Mbrojtja nuk deklarohet për hetimet

Pierre Prosper, avokat i Hashim Thaçit, në lidhje me hetimet e mbrojtjes, ka deklaruar se nuk kanë mundësi të japin detaje. Ai ka thënë se do të duhet të marrin më shumë informacione nga prokuroria për të dhënë detaje. Ndërsa Ben Emmerson, avokat i Kadri Veselit, ka treguar se ka krijuar një ekip hetimor dhe janë në pozitë të fillojnë hetimet. “Kemi bërë ushtrimin e parë të triazhit dhe, siç e kam thënë,

për çudinë time, nuk ka qoftë edhe një akuzë të vetme, pretendim të vetëm kundër Veselit në një sjellje specifike që mund ta çojë atë në kryerjen apo pjesëmarrjen në një krim. Për momentin nuk kemi prova dhe nuk dimë çfarë juridiksioni ka gjykata që t’i hetojë këto akuza”, ka thënë ai. Edhe avokati i Selimit ka thënë se nuk mund të deklarohen sa iu përket hetimeve. “Ne po kalojmë me shpejtësi informacionin që na është dorëzuar nga ZPS, por nuk mund të jap informacion për hetimet”, ka thënë Young. Ndërkaq avokatja e Krasniqit ka thënë se qëndrojnë pranë parashkrimeve me shkrim dhe nuk janë në gjendje të japin përditësime të tjera.

Të pandehurit nuk kanë marrë pjesë fizikisht në këtë konferencë. Ata seancën e kanë ndjekur përmes videolidhjes. Në fund, palët u pajtuan që konferenca e radhës të mbahet në muajin qershor. Konferencën statusore e thërret gjykatësi i procedurës paraprake dhe ajo ka për qëllim organizimin e shkëmbimeve ndërmjet palëve. Në këtë konferencë Prokuroria tregon çfarë lloji të provave ka. Ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqit rëndojnë akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Ata janë deklaruar të pafajshëm dhe që nga nëntori i vitit 2020 gjenden në paraburgim në Hagë.

Qeveria Kurti kap “fshesën” për largimin e ambasadorëve politikë

Prishtinë, 19 maj (ER)- Ministria e Punëve të Jashtme, e cila drejtohet nga Donika Gërvalla-Schwarz, ka kapur “fshesën” për t’i larguar ambasadorët e emëruar politikë. Ky largim i ambasadorëve politikë po bëhet në bashkëpunim në mes të MPJ-së dhe Presidencës. Burime të mirinformuara të gazetës “Epoka e re” brenda

diplomacisë së Kosovës kanë bërë me dije se disa ambasadorë që janë në fund të mandatit, por edhe të tjerë që janë në gjysmë të mandatit, kanë marrë telefonatë nga MPJ për largim nga detyra e ambasadorit.

Këto burime të gazetës “Epoka e re” thonë se disa ambasadorë, pos telefonatës që kanë marrë nga MPJ-ja për

largim nga pozita e ambasadorit, ata do të njoftohen për largimin e tyre edhe përmes njoftimit zyrtar në ditët e ardhshme.

Në ditët e ardhshme “Epoka e re” do t’ju njoftojë më gjerësisht se pos qeverisë Kurti, kush tjetër është në prapavijë për shkarkimin e disa ambasadorëve që pritet të ndodhë këto ditë.



Si të mbrohemi nga populizmi?

Kodi i deshifrimit të politikave qeverisëse të LV-së dhe të Kurtit gjendet në të kaluarën e tyre populiste. Detyra e opozitës është që me këtë kod ta demaskojë dhe parandalojë qeverisjen populiste pandalshëm. Kjo do të thotë ta mbrosh qytetarin dhe Kosovën nga majtizmi populist me demokraci dhe pragmatizëm. Kjo mund të marrë kohë, sepse është koha e populistëve



Shkruan: Faton
ABDULLAHU

Nëse me parime dhe qëndrime të caktuara politike një parti merr vota nga qytetari, pra i fiton zgjedhjet, e mandej këto parime e qëndrime të njëjta duken qenë në qeveri, i shkel i tradhton dhe nuk i zbaton, ato vota e ato simpati duhet të humben me patjetër dhe në emër të demokracisë. Detyra e

opozitës është që ta demaskojë këtë politikë joparimore dhe ta bëjë këtë sa më shpejt e sa më bindshëm. Qeveria Kurti ende pa i mbushur 100 ditë ka shkelur të tilla parimet në mënyrë të pamoralshme të përcudshme dhe shumë jo të zakonshme. Disa këtë diskrapancë përpiqen ta justifikojnë me faktin se pritishtërit nga qeveria aktuale janë shumë të larta, sepse zhgënjimi i qytetarit të Kosovës që 20 vjet ka qenë i jashtëzakonshëm. Në të vërtetë, nuk është kështu. Pritishtërit nga qeveria Kurti janë shumë të larta sepse LV-ja dikur në opozitë, që ta ngrehë dhe bëjë më të bindshme akuzën ndaj të tjerëve, ka aranzhuar

qëllimshëm dhe me djallëzi pritishtëri krejt ekstraordinere. Pse? Sepse sa më shumë që i ka ngritur pritishtëritë si standarde politike LV-ja në opozitë, aq më të rrepta e besa edhe më bindëse janë dukur akuzat ndaj qeveritarëve të ndryshëm. Por ja që tani kjo i kthehet bumerang Qeverisë Kurti. Dhe kjo nuk do të ketë të ndalur. Sepse sa më pak i plotëson ato pritishtëritë të vendosura dje, aq më i madh dhe më shpejt rritet zhgënjimi për qeverinë Kurti sot. Prandaj edhe skeptikët më të mëdhenj çuditën këto ditë me gabimet dhe axhamillëkun e shumë të shpejtë në qeverisje. Thjesht, demokracia nuk e duron mashtrimin apo, së paku, nuk mund ta duroj gjatë. Kur populizmi me mashtrim e dhunon demokracinë, dështimi si akt i parakohshëm është rrjedh normale e demokracisë. Dhe detyrë e opozitës është që ta mbrojë progresiven nga e reja regresive, thjesht ta mbroj demokracinë. Disa të tjerë thonë se LV-ja dhe Kurti nuk janë të marrë dhe do të ndryshojnë dhe duhet të

ndryshojnë, sepse (u konë çka u konë) tani gjenden në rrethana të tjera, tani LV-ja qeveris dhe Kurti është kryeministër. Ka një problem këtu dhe shumë të madh bile. Në të vërtetë Kurti dhe qeveria e tij nuk do të duhej të ndryshojë aspak. Sepse duke premtuar e pasur qëndrime e vlerësime të cilat i ka pasur në opozitë, ai ka fituar vota, shumë vota. Nëse ndryshon, po i bie që ka mashtruar, që nuk ka qenë realist apo, edhe më saktë, ka qenë populist. Prandaj opozita ka obligim që çdo ndryshim të tij në raport me parimet, qëndrimet e vlerësimet t'i konvertojë në humbjen e votave, të simpatisë dhe mbështetjes së kësaj qeverie. Nëse dikush pas kësaj që vlerësova, konstaton se kjo do të thotë të merresh e të mbetesh në të kaluarën e LV-së dhe të politikës në përgjithësi, e ta harrosh të tashmen, unë ju përgjigjem se pa këtë segment, pra pa e kuptuar populizmin e LV-së në opozitë, pa e sjell në vëmendjen e qytetarit vazhdimisht, nuk mund të kuptohet populizmi i saj në qeverisje. Prandaj kodi i

deshifrimit të politikave qeverisëse të LV-së dhe të Kurtit gjendet në të kaluarën e tyre populiste. Detyra e opozitës është që ta demaskojë populizmin në qeveri pandalshëm. Kjo do të thotë ta mbrosh qytetarin dhe Kosovën nga populizmi dje, sot dhe nesër, me demokraci.

Krejt kjo që thashë nuk është krejt. Në të vërtetë do të mbetet shumë e mangët po nuk konstatova se, nëse opozita nuk gjen forcë që të bëjë ndryshime të mëdha kadrovike dhe ideore, detektorët e tij opozitarë nuk do ta detektojnë populizmin e qeverisë sepse edhe ajo pavetëdijshëm do të sharrojë në vorbullën e neveritshme populiste. Kështu, qytetari i Kosovës më lehtë do ta gëlltitë rrenën e populistëve të rafinuar në qeveri sesa të vërtetën opozitare të pareformuar. Prandaj, para se opozita ta mbrojë Kosovën nga populizmi me demokraci, duhet ta kuptojë drejt se nuk ka demokraci në taborin e humbësve, pa reforma ideore dhe kadrovike për t'i mundur populistët e pariparueshëm.

Marsh protestues në Prishtinë kundër ngacmimeve seksuale

Prishtinë, 19 maj - Nxënësit e tri shkollave të mesme të kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës, të mërkurën në sheshin kryesor të qytetit kanë mbajtur një marsh protestues me moton "Traumë, jo lojë". Ky marsh është mbajtur pas rastit të sulmit seksual ndaj një vajze të mitur në Prishtinë që raportohet se ka ndodhur muajin e kaluar.

Protestuesit kanë thënë se "protestojmë për vajzat, gratë, motrat dhe nënat tona, sepse është "Traumë, jo lojë". Njëherësh ata kanë kërkuar rritje të vetëdijesimit në raport me fenomenin e ngacmimeve seksuale.

Protesta është organizuar nga nxënësit e gjimnazeve, "Xhevdet



Doda", "Sami Frashëri" dhe "Ahmet Gashi".

Marshit protestues i është bashkuar edhe ish-presidentja e

Kosovës, Atifete Jahjaga. "Të rriten djemtë dhe vajza në të njëjtën mënyrë e të barabartë brenda mureve të shtëpisë, të mos

lejojmë djemtë t'i nënçmojnë motrat e tyre apo këdo tjetër, por t'iu mësojmë dashurinë dhe respektin", ka shkruar Jahjaga në

rrjetin social "Facebook".

Mediat në Kosovë javën e kaluar kanë shpërndarë një video ku pretendohet për ngacmim seksual të një të miture nga tre fëmijë, në oborrin e shkollës "Faik Konica" në Prishtinë.

Drejtorja e kësaj shkolle, përmes një komunikate për media, ka thënë se që nga pranimit e videos (më 24 prill), nga burime të pidentifikuara, për rastin në fjalë ka ndërmarë të gjitha masat si brenda edhe jashtë shkollës, duke njoftuar prindërit e të dy palëve, policinë e komunitetit, Qendrën për Punë Sociale dhe organe të tjera kompetente dhe të gjithë personat që kanë mundur të preken në mënyrë indirekte nga rasti.

Tetë të vdekur dhe 62 raste të reja me Covid-19

PRISHTINË, 19 MAJ (ER) - Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe në laboratorët privatë me metodën RT-PCR si dhe në laboratorët publikë dhe privatë me metodën RAT janë testuar gjithsej 4 049 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të

rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 62 raste pozitive me Covid-19.

Brenda 24 orëve janë raportuar tetë raste të të vdekurve si pasojë e këtij virusi.

Rastet e të vdekurve janë nga komunat: Prishtinë dy raste (69, 55 vjeç), Malishevë një rast (72 vjeç), Mitrovicë një rast (69 vjeç), Obiliq një rast (89 vjeç), Prizren një rast (74 vjeç), Rahovec një rast (61

vjeç), Suharekë një rast (76 vjeç).

Numri total i rasteve pozitive është 107 065 raste nga 579 663 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 2 235 raste të vdekjes.

Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 379 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 100 612 raste, kurse numri i rasteve aktive është 4 218.



Për të shpëtuar nga vdekja i thyem dyert e qelive të burgut të Dubravës

Nisi më 19 maj dhe zgjati shumë



Shkruan: Sadik ZEQRIL, ish i burgosur në burgun e Dubravës

Që ishte skenar i regjimit serb kjo nuk diskutohet, por që ishte përgatitur kaq mirë nga skenaristët për të zhdukur gjurmët dhe që të mos merret askush me këtë masakër e gjenocid, as nga gjykatat vendore e as nga ato ndërkombëtare kjo është për shqetësim. Skenari serb, filloi me sjelljen e të burgosurve shqiptarë në Dubravë nga burgjet e tjera, po realizohej. Pas shumë provokimeve të forcave serbe nga pozicionet e arsenalit luftarak që ishin

vendosur qëllimisht në objektet e burgut të Dubravës dhe në rrethinën e saj, arritën që një ditë forcat e NATO-s t'i detyronin që t'u përgjigjeshin këtyre sulmeve kundërajrore të forcave serbe. NATO në ato çast nuk e dinte se Serbia aty kishte sjellë të burgosurit shqiptarë për t'i përdorur 'mish për top'. Serbia kohë më parë i kishte larguar të gjithë të burgosurit nga Dubrava dhe aty kishte futur njësitë speciale serbe, më pas i kishte larguar ato dhe kishte bërë grumbullimin e të burgosurve shqiptarë. Para se të ndodhte bombardimi i hapësirave brenda burgut, në afërsi ndodhej fshati Shushicë,

që çdo ditë digjej e plaçkitesh nga ushtria dhe policia serbe. Ne e shihnim luftën si në filma. Kjo na mundësohej pasi ishim në katin e dytë të Pavijonit C dhe shikonim nga dritarja. Pas një rezistence të UÇK-së, e cila me siguri i detyroi të largoheshin, filloi dëgjia e fshatit. Dëgjohej gërvalla e bagëtime, shiheshin gratë dhe fëmijët që ngjiteshin malit përpjetë. Një gardian, me flokë të bardha nga rrethi i Dubravës, hyri në dhomën tonë dhe na zuri duke shikuar nga dritarja dhe na tha: "Ai është fshati Shushicë dhe vetëm në atë fshat janë disa shqiptarë gjallë dhe ju që jeni në burg, ndërsa pjesën tjetër ose i kemi vlarë ose i kemi deportuar nga Kosova".

Ditët ecnin, luftë bëhej e ne rriheshim çdo ditë nga gardianët serbë dhe nga milicia serbe derisa erdhi mëngjesi i 19 majit të vitit 1999, kur aeroplanët që është shumë e mundur se kanë qenë serb bombarduan në Dubravë, Pavijonin C. Ato goditën pavijonin në mes, në të cilën ishte një dhomë me mbi 20 të burgosur shqiptarë. Në të mbetën të vdekur tre të burgosur: Gjokë Ndrecaj,

Avdullah Tahiri dhe Enver Topalli e shumë të tjerë u plagosën.

Kjo mund të vërtetohet me atë se ka qenë kanë mundur të jetë aeroplan bombardues serb, sepse gjatë ditëve të tmerrit brenda hapësirave të burgut, kur hynë këmbësoria serbe me ushtar, paramilitar, gardian, policë e të burgosur serb që tashmë ishin armatosur, shumicën e të burgosurve shqiptar që ishin fshehur nëpër puseta, i kanë ekzekutuar me bomba dore vetëm e vetëm që nëse ndonjëherë bëhet ndonjë gjyq dhe ekspertizë mjeko-ligjore, të thuhet se ata janë vlarë nga granatat e avionëve.

Të gjithë thonë se dyert e burgut hapen dhe mbyllen veç me çelësa, ndërsa unë me shokët e dhomës – Shkumbinin, Ardianin, Gëzimimin e Halitin – i thyemë ato me një shtrat. Ne pesë të burgosurit në dhomë, pasi e shkatërruam një shtrat, edhe pse nuk kishim fuqi pikën, sepse ishim afërsisht nga 50 kg peshë, katër prej nesh me shtratin e shkatërruar e goditëm derën e qelisë me ritëm të shpejtë e forcë të repte. Pas shumë goditjeve, e thyem

derën e burgut, së bashku me pjesën e murit që ishte e kapur dhe dolëm nëpër korridorin e mbushur me mure të rrëzuara e shokë të plagosur. Më vonë, pasi nga dritaret e qelive kërkohej ndihmë për të shpëtuar të tjerët, sepse çelësa të qelive për t'i hapur dyert nuk kishte askund, sepse gardianët kishin ikur sapo kishin rënë bombat, kanë ardhur të burgosurit shqiptarë të pavijoneve të tjera që kanë qenë më të lira, e me kazma dhe mjete të tjera i kanë thyer e hapur dyert e tjera të burgut. Pas daljes nga pavijoni ne menduam se po dalim jashtë burgut, se po dalim në liri, por në mes të oborrit na dolën përpara gardianët dhe të burgosurit serbë të cilët veç filluan të armatoseshin dhe, me armë në duar e në drejtim tonin, na detyruan të ndalemi e të ulemi në tokë.

Sa herë që vijnë ditët e 19-24 majit më kujtohen ditët e gjenocidit serb të vitit 1999, masakra e Dubravës dhe shumë e shumë të tjera të kryera në Kosovë, për të cilat, edhe pse kërkohet drejtësi që 22 vjet, deri më tash drejtësia dhe zëri ynë kanë mbetur në qiell sikurse kujtimet dhe ankthi ynë përbrenda nesh.

Masakra në burgun e Dubravës, akt i gjenocidit!

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 MAJ - Me rastin e 22-vjetorit të masakrës në burgun e Dubravës, Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" ka theksuar se gjatë javës së fundit të muajit prill 1999 dhe dy javëve të para të muajit maj 1999, në burgun e Dubravës u bë grumbullimi i pengjeve shqiptare nga disa burgje serbe ku ishin mbajtur deri atëherë. "Përzgjedhja, transferimi dhe sistematizimi i tyre në pavijonet e burgut të Dubravës u bë në funksion të kryerjes së një nga krimet më të shëmtuara në kuadër të zbatimit të gjenocidit ndaj shqiptarëve në Kosovë: vrasjen masive të pengjeve të luftës! Më datë 19 maj 1999 aeroplanët e NATO-s bombarduan caqet ushtarako-policore serbe që ndodheshin jashtë mureve të burgut të Dubravës. Pas tërheqjes së tyre, avioni jugosllav sulmoi pavijonet e stërmbushura me shqiptarë, me ç'rast u vranë Enver Topalli, Abdullah Tahiri



KALENDARI I GJENOCIDIT

MASAKRA NË BURGUN E DUBRAVËS

19 - 24 MAJ 1999

dhe Gjokë Ndrecaj, ndërsa u plagosën 19 të tjerë. Në përputhje me strategjinë për fshehjen e gjurmëve të krimit të gjenocidit, propaganda gebelsiane në krye me ministrin e atëhershëm të Informatave të regjimit të Sllobodan Millosheviqit, Aleksandër Vuçiq, krimet e avionit jugosllav ia atribuoi

NATO-s", është thënë komunikatën e kësaj qendre. Qendra "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur" thekson se, përkundër asaj se në konferencat për shtyp të datës 21 maj 1999, Pentagoni dhe NATO hodhën poshtë propagandën serbe dhe me prova të pakontestueshme të mbështetura në incizimet e

aksioneve të bombardimeve të caqeve ushtarako-policore, dëshmuar se asnjë bombë e tyre nuk kishte rënë brenda mureve të burgut, propaganda e Aleksandër Vuçiqit vazhdoi me të njëjtin avaz. "Kjo propagandë serbe e fajësimit të NATO-s për krimet që kishte planifikuar t'i kryente vetë, vazhdoi me intensitet të shtuar

deri më 24 maj, kur përfundoi një nga krimet më makabre të gjenocidit në Kosovë. Gjatë gjenocidit në burgun e Dubravës forcat serbe vranë 117 të burgosur shqiptarë dhe plagosën mbi 400 të tjerë, 100 prej të cilëve ishin në gjendje tejet të rëndë. Sot mbushen 22 vjet që nga fillimi i këtij krimi monstruoze dhe askush nga zinxhiri komandues i forcave të armatosura serbe apo nga ata që ekzekutuan planin e vrasjes së pengjeve në burgun e Dubravës nuk është përgjigjur për këto akte kriminale! Për dallim nga koha kur Aleksandër Vuçiqi ishte ministër i Propagandës gjenocidare të Serbisë, sot në cilësinë e presidentit të shtetit vazhdon ta mohojë përgjegjësinë për përgatitjen dhe zbatimin e këtij akti gjenocidar dhe për këtë fajëson forcat e NATO-s. Qendra 'Gjenocidi në Kosovë-Plagë e hapur' kërkon drejtësi për të gjitha viktimat e gjenocidit në burgun e Dubravës, është thënë, ndër të tjera, në komunikatën e Qendrës "Gjenocidi në Kosovë - Plagë e Hapur".

Për kontrabandim të barnave dhe marrje të mitos arrestohet një oficer doganor dhe një person i dyshuar

**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 MAJ - Njësitë e Doganës kanë gjetur sasi të barnave në një veturë në afërsi të pikëkalimi kufitar dhe në bazë të dyshimit të arsyeshëm është arrestuar personi dhe zyrtari doganor. Të martën në orët e mbrëmjes zyrtarët doganorë, pas dyshimeve, kanë ndaluar një veturë të dyshimtë për kontrabandë të mundshme të barërave. Pas ndalimit të automjetit është gjetur sasi e konsiderueshme e barërave në pjesën e bagazhit. "Bazuar në indikacionet e mëtejme, zyrtarët doganorë hetues kanë arritur të mësojnë se personi në fjalë ka edhe një depo të improvizuar private në një parking nëntokësor në Prishtinë. Duke vepruar mbi këto indikacione dhe në bashkëpunim dhe udhëheqje të Prokurorisë Themelore të Ferizajt, zyrtarët doganorë kanë hyrë në këtë depo, ku kanë gjetur stok të konsiderueshëm të barërave ilegale në sasi prej 17 923 pakosh, 359 lloje të barnave. Bazuar në provat e gjetura

dhe sipas urdhrit të Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, është konstatuar dyshimi i arsyeshëm se zyrtari doganor në detyrë ka qenë i përfshirë në lejin e kontrabandës", është thënë në njoftimin e Doganës.

Me këtë rast, hetuesit e Doganës, pas urdhrit nga prokurori, kanë arrestuar zyrtarin doganor si dhe personin e dyshimtë, ndërsa barërat ilegale janë sekuestruar të gjitha. "Suspendimi i zyrtarit përgjegjës do të bëhet me efekt të menjëhershëm, ndërsa që do të iniciohet hetim mbi përgjegjësinë menaxheriale të mbikëqyrësit të zyrtarit në fjalë", është theksuar në njoftim.

Dogana e Kosovës siguron publikun se çmon lart shëndetin e qytetarëve të saj, sigurinë e produkteve, sikurse që kërkojnë të luftojnë të gjitha format e keqpërdorimit dhe neglizhencës së detyrës zyrtare, andaj Dogana kërkon bashkëpunimin e qytetarëve, duke i siguruar të gjithë se do të bëjnë gjithçka që identiteti i qytetarëve që bashkëpunojnë të ruhet me kujdes të veçantë.



ATK-ja: Do të marrim masa për ata që nuk paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale



PRISHTINË, 19 MAJ (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës ka rikujtuar të gjithë personat fizikë joafaristë, personat fizikë afaristë dhe personat juridikë, se janë të detyruar t'i deklarojnë dhe t'i paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale në mënyrë reale dhe në kohë ashtu

siç është përcaktuar me legjislacionin tatimor. Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te personat të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë tatimin dhe kontributet pensionale. "Për personat fizikë

joafaristë, personat fizikë afaristë dhe personat juridikë të cilët nuk deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë tatimet dhe kontributet pensionale, ATK-ja do të ndër marrë masa ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor. ATK-ja u bënë thirrje të gjithë personave që t'i deklarojnë

të ardhurat e krijuara apo t'i korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe t'i përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor. Me kryerjen e detyrimeve tatimore kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë:

ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore", theksohet në njoftimin e ATK-së.

Ekonomia në Shqipëri po jep sinjale të rimëkëmbjes

TIRANË, 19 MAJ (ER) - Ekonomia në Shqipëri po jep sinjale rimëkëmbje, pasi treguesit e buxhetit të shtetit janë përmirësuar më tej edhe gjatë muajit prillit. Të dhënat zyrtare të financave tregojnë se në katërmujorin e këtij viti janë grumbulluar 152.2 miliardë lekë të ardhura nga tatimet dhe doganat, rreth 20 miliardë lekë më shumë se një vit më parë. Statistikat tregojnë se arkëtimet kanë kaluar edhe nivelet e para

të krizës, pasi kanë shënuar rritje edhe në raport me vitin 2019, duke sinjalizuar edhe një përmirësim të ecurisë së bizneseve dhe ekonomisë në tërësi. Por, cilat janë zërat që kanë pasur ecurinë më të mirë të arkëtimeve? Sipas të dhënave, tatimi mbi vlerën e shtuar gjeneroi rreth 43 miliardë lekë, duke iu afruar nivelit të vitit 2019, çka tregon se konsumi po shfaq sinjale përmirësimi.

Zgjerim kanë parë edhe të ardhurat nga taksat e punës, tatimi mbi të ardhurat personale si dhe zëri i sigurimeve shoqërore e shëndetësore pasi u rritën jo vetëm në raport me vitin 2020, por edhe me vitin normal të 2019-s. Një ecuri e tillë e këtyre zërave mund t'i atribuohet përmirësimit të ecurisë së bizneseve e përmirësimit të tregut të punës me rimarrjen

në punë të punonjësve si dhe efekteve të rritjes së pagës minimale në vend. Edhe pse janë rritur në këtë katërmujor në raport me vitin 2020, të ardhurat nga tatim fitimi dhe të ardhurat e bashkive rezultojnë në rënie me nivelet e para të krizës, duke reflektuar edhe efektet që ka dhënë pandemia. Edhe shpenzimet buxhetore nga ana tjetër kanë ndjekur një trend në rritje në muajt janar-

prill, duke arritur në 166.9 miliardë lekë, mbi 18 miliardë lekë më shumë se në vitin 2020. Ajo që vihet re nga të dhënat është një rritje e ndjeshme si e shpenzimeve korrente për paga e shpenzimeve operative mirëmbajtje ashtu edhe për ato kapitale kryesisht për investime. Ndërsa deficitin buxhetor pësoi rënie me rreth 927 milionë lekë, pasi rezultoi në 14.6 miliardë lekë në fund të prillit.



KPMSHCK-ja në vitin 2020 shpenzoi 273 mijë euro

PRISHTINË, 19 MAJ (ER) - Në mbledhjen e Komisionit për Buxhet, Punë dhe Transfere është shqyrtuar të mërkurën raporti vjetor financiar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK) për vitin 2020. Për këtë rast ka raportuar Miran Zeneli, sekretar i këtij këshilli, i cili ka theksuar se nga buxheti prej 360 mijë eurosh kanë shpenzuar 273 mijë euro, prej tyre 195 mijë euro paga dhe mëditje, si dhe për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 77 mijë euro.

Zeneli ka thënë se shpenzimet e këtij buxheti janë bërë në pajtim me ligjin në fuqi. Kurse deputeti nga LV-ja, Visar Korenica, ka ngritur çështjen e rritjes së shpenzimeve për paga pas orarit të punës dhe rritjen e



shpenzimeve për dreka dhe darka, ndërsa ulje të shpenzimeve për sigurimin e automjeteve edhe pse ka rritje të çmimit të primit. "Keni

tejkalar shpenzimet për dreka dhe darka. Shpenzimi i sigurimit të automjeteve është ulur edhe pse primi është rritur", është shprehur Korenica.

Islam Caka, zyrtar financiar në këshill, ka thënë se sa i përket tejkallimit, është një shumë e vogël, ndërsa sa i përket sigurimeve, Caka ka thënë se

numri i automjeteve në këshill është zvogëluar. Pas shqyrtimit, komisioni ka shtyrë votimin e këtij raporti për mbledhjen e ardhshme, meqë pati disa vërejtje nga diskutimet dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Anëtarët e Komisionit në këtë mbledhje kishin paraparë edhe shqyrtimin e raportit të Bankës Qendrore të Kosovës për të gjeturat e raportit të progresit për vitin 2020, për të cilin raport do të kishte raportuar guvernatori Fehmi Mehmeti por, për shkak të vazhimit të seancës plenare të Kuvendit të mërkurën, Komisioni ka shtyrë për një mbledhje tjetër. Komisioni me shumicë votash ka miratuar raportin vjetor financiar të Agjencisë për Informim dhe Privatësi për vitin 2020.

Pas 14 javëve, vlera e Bitcoinit bie nën 40 000 dollarë

PRISHTINË, 19 MAJ - Kriptoaluta më e madhe në botë, Bitcoin, ka rënë në 40 000 dollarë për herë të pas 14 javëve të fundit. Sipas të dhënave të CoinDesk,

Bitcoin ka humbur vlerën për 13 për qind duke rënë në 38.585,86 dollarë. Ky është niveli më i ulët që nga 9 shkurti, kur për herë të fundit kishte rënë nën 40

000 dollarë. Rënia e shitjes ka ndodhur si pasojë e deklaratave të drejtorit të kompanisë Tesla, Elon Musk, i cili tha se kjo kompani ka ndalur blerjen e

veturave të saj me Bitcoin. E komentet e Muskut kanë bërë që po atë ditë tregu në nivel global i kriptoalutave të bie nën 300 miliardë dollarë.



Asociacioni i Komunave kërkon nga qeveria adresimin e sfidave me të cilat po ballafaqohen komunat

PRISHTINË, 19 MAJ (ER) - Këshilli i Kryetarëve, në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, ka mbajtur takimin e radhës në të cilin ka diskutuar për problemet dhe sfidat aktuale të komunave, agjendën legislative të qeverisë për vitin 2021 dhe pjesëmarrjen e AKK-së në grupet punuese si dhe për bashkëpunimin ndërinstitucional mes nivelit lokal dhe atij qendror.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Imri Ahmeti, ka thënë se si AKK kanë pranuar agjendën legislative të qeverisë për vitin 2021 ku nga 190 projektligje tani kanë targetuar 36 sosh që prekin fushëveprimtarinë e komunave dhe qeverisjen lokale në përgjithësi. Ai ka thënë se brenda strukturave të AKK-së do ta rishikojnë këtë listë, ndërsa ka thënë se edhe nga komunat presin adresimin se cilat projektligje do të orientohet në punë.

Ndërsa drejtori ekzekutiv i AKK-

së, Sazan Ibrahim, ka elaboruar listën e propozuar të projektligjeve për të punuar me kolegjiomet e AKK-së dhe strukturat e tjera në mënyrë që nëpër grupet punuese të hartimit dhe plotësimit të këtyre akteve ligjore, komunat të përfaqësohen me qëndrime të qarta dhe në mbrojtje të interesave të pushtetit lokal të Kosovës. Po në këtë takim u diskutua edhe lidhur me bashkëpunimin ndërinstitucional mes pushtetit lokal dhe qendror.

Asociacioni i Komunave të Kosovës me këtë rast u tha se është i gatshëm për bashkëpunim të hapur dhe institucional në mënyrë që paraqitja dhe mbrojtja e interesave të pushtetit lokal të vazhdojë të jetë boshti i punës së AKK-së.

Pas diskutimeve, kryetarët e komunave janë pajtuar për gjashtë rekomandime të Këshillit të Kryetarëve: 1. Asociacioni i



Komunave të Kosovës do ta dërgojë në Qeverinë e Kosovës listën me të cilën do të kërket nëpër grupet punuese për projektligjet e parapara sipas agjendës legislative për vitin 2021 e që atakojnë nivelin lokal dhe do ta japë kontributin e vet edhe përmes strukturave të ndryshme të saj; 2. Obligimet që dalin nga implementimi i Kontratës Kolektive të mbulohen

nga niveli qendror meqë komunat nuk kanë qenë nënshkruese të marrëveshjes derisa për zbatimin e saj tani po dëmtohen komunat me tërheqje të mjeteve nga buxhetet komunale; 3. Asociacioni i Komunave shpreh gatishmërinë e plotë për bashkëpunimin me nivelin qendror në interes të komunave dhe qytetarëve të tyre; 4. Të deblokohet rekrutimi i stafit

të rinj nëpër komuna, qoftë edhe duke lejuar zbatimin e ligjit të vjetër deri në miratimin e ligjit të ri; 5. Të zgjidhet sa më parë Bordi i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSH) meqë shumë projekte të investimeve kapitale mund të ngecin në implementim; dhe 6. Të thjeshtohen procedurat për zëvendësimin e përkohshëm të personelit arsimor nëpër komuna.

Mërgimtarit nga Gjermania dhuron tetë karroca për personat me nevoja të veçanta


Rahovec, 19 maj (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se afaristi nga Drenoci, Nevzat Berisha, i cili jeton në Gjermani, ka dhuruar një donacion prej tetë karrocash për personat me nevoja të veçanta. "Njeriu i mirë dhe afaristi i vyeshëm nga Drenoci, Nevzat Berisha, i cili aktualisht jeton dhe vepron në Gjermani, ka dhuruar një donacion prej tetë karrocash për

personat me nevoja të veçanta, të cilat do t'u ndihmojnë personave që më lehtë t'i kryejnë nevojat e tyre dhe të lëvizin lirshëm. Ai, po ashtu, ka dhuruar edhe 500 euro të holla për familjet në nevojë të Komunës së Rahovecit. E falënderoj Nevzatit për ndihmën, solidaritetin dhe humanizimin e tij!", ka shkruar kryetari Latifi në llogarinë e vet në "Facebook".



Komuna e Kamenicës furnizon shkollat fillore me Multiboard

KAMENICË, 19 MAJ (ER) - Komuna e Kamenicës ka pajisur gjashtë shkolla fillore me Multiboard, pajisje këto të cilat janë shumë funksionale dhe mund të përdoren gjatë orëve mësimore në të gjitha lëndët. "Nga këta Multiboard fëmijët do të mund të mësojnë për format më të reja teknologjike dhe t'i praktikojnë ato. Shuma e këtij investimi është mbi 18 mijë euro", ka njoftuar Komuna e Kamenicës.



UNMIK-u dhuron pako ushqimore për familjet me gjendje të rëndë sociale në Prishtinë

PRISHTINË, 19 MAJ (ER) - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) ka dhuruar 194 pako ushqimore dhe higjienike për familjet me situatë të rëndur sociale ekonomike, e cila u është vështirësuar edhe më shumë gjatë kohës së pandemisë. Komuna e Prishtinës ka falënderuar UNMIK-un për mbështetjen dhe ndihmën për qytetarët e Prishtinës, sidomos në këto ditë me plot sfida.





Mehmet Kraja ka lindur më 1952, në Krajë, afër Liqenit të Shkodrës, në Mal të Zi. Shkollimin e mesëm e kreu në Ulqin, ndërsa të lartin në Universitetin e Prishtinës, degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, në vitin 1975. Në vitet 1974-'76 ishte kryeredaktor i gazetës së studentëve "Bota e re". Më pas punoi gazetar dhe redaktor i kulturës në gazetën "Rilindja". Në fillim të viteve '90 të shekullit XX u përfshi në zhvillimet politike të asaj kohe dhe ishte një nga themeluesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Gjatë viteve 1992-'99 jetoi dhe punoi në Tiranë, së pari në Zyrën e Kosovës dhe më pas redaktor në gazetën "Rilindja", botim i Tiranës. Pas luftës së vitit 1999 disa muaj ishte redaktor i kulturës në të përditshmen "Zëri", ndërsa nga viti 2000 redaktor i shtojcës për kulturë në gazetën "Koha ditore", si bashkëpunëtor i jashtëm. Në periudhën 2002-2018 ishte mësimdhënës në Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës. Nga viti 2005 është anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Ka botuar trembëdhjetë romane ("Udhëzime për kapërcimin e detit", "Sëmundja e ëndrrave", "Im atë donte Adolfin", "Selvitë e Tivarit", "Hotel Arbëria", "E zeza dhe e kuqja", "Prishtina" etj.), katër përmbledhje me tregime ("Vdekja pa emër", "Portat e qiellit" etj.), pastaj tetë drama ("Princi i hijeve", "Hëna prej letre", "Grafitet" etj.), si dhe shumë shkrime publicistike me angazhime kulturore dhe politike. Ka fituar një sërë çmimesh letrare në Kosovë dhe në Shqipëri.

5.99€

ISBN 978-9951-780-56-8



Mehmet Kraja • HËNA PREJ LETRE



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**


Nika: Prishtina do të ketë paraqitje dinjitoze në Ligën e Kampionëve

Portieri Ardit Nika ka shprehur optimizëm se skuadra më e suksesshme në vend, Prishtina, do të ketë përfaqësim dinjitoz në Ligën e Kampionëve. "FC Prishtina mendoj se është e gatshme për garat e Ligës së Kampionëve për arsye se Prishtina ka përvojë dhe mendoj se do t'ia dalim që ta prezantojmë futbollin e Kosovës në mënyrën më të mirë", ka thënë Nika

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 19 MAJ - Portieri i FC Prishtina, Ardit Nika, ka thënë për "Epokën e re" se rrugëtimi i kësaj skuadre drejt titullit kampion nuk ishte aspak i lehtë sepse skuadrat kundërshtarë, Drita dhe Ballkani, kishin dallim të madh me pikë. Sipas portierit, kryeqytetasit e rikthyen titullin pas tetë jetësh për faktin se besuan se në këtë kampionat mund të dalin të suksesshëm dhe se nuk u dorëzuan për asnjë çast. "Vërtet ishte shumë e vështirë të arrihej titulli i kampionit, duke e ditur se ishim me pikë larg kundërshtarëve tanë direkt, por ishte shpresa, dëshira dhe guximi që na shtynë deri tek arritja e qëllimit që kishim për t'u shpallur kampionë. Çelësi kryesor i këtij suksesi ishte që trajnerët dhe kryesia nuk e humbën kurrë besimin te ne dhe nuk u ndalën kurrë me fjalët motivuese dhe duke na qëndruar gjithmonë pranë, derisa gjithsecili në klub e ka dhënë maksimumin që të shpallemi kampionë", ka deklaruar Nika.

Prishtina në të kaluarën ka marrë pjesë në Ligën e Evropës, por sivjet për herë të parë do të marrë pjesë në garat parakualifikuese të Ligës së Kampionëve. Portieri Nika ka shprehur optimizëm se skuadra më e suksesshme në vend do të ketë përfaqësim dinjitoz në Evropë. "FC Prishtina mendoj se është e gatshme për garat e Ligës së Kampionëve për arsye se Prishtina ka përvojë dhe mendoj se do t'ia dalim që ta prezantojmë futbollin e Kosovës në mënyrën më të mirë", ka thënë Nika, i cili në fund ka bërë edhe një parashikim për kampionatin e ardhshëm 2021/2022, ku ka thënë se klubi "bardhekaltër" do të luftojë si gjithmonë për trofe. "Prishtina jo vetëm në kampionatin tjetër, por gjithmonë lufton për titullin kampion dhe Kupë, sepse është klubi më i trofeshëm në Kosovë dhe kjo tregon se është klub që



çdoherë jep atomin e fundit për t'u shpallur kampion", ka përfunduar Nika. Ndashjen e fundit të këtij

edicioni Prishtina e zhvillon të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" kundër Ballkanit.

SHKURT

Tre lojtarë nga FC Malisheva marrin ftesë nga Përfaqësuesja e Kosovës

FC Malisheva, pas inkuadrimit në Superligë, ka marrë lajme të mira për lojtarët e vet. Tre lojtarë kanë marrë ftesë nga Përfaqësuesja e Kosovës. Lajmin e ka konfirmuar për "TV Malisheva" trajneri Arsim Thaqi. Albion Rrahmani, Donart Vitija dhe portieri Flamur Gashi janë tre lojtarët që i janë bashkuar Përfaqësueses së Kosovës, grupmosha U21. Kujtojmë se FC Malisheva ditë më parë ka fituar titullin në Ligën e Parë duke kaluar kështu në garë të Superligës.

Dënohet Tare

Ndeshja e prapambetur në mes të Lazios dhe Torinos u mbyll pa gola, duke zyrtarizuar shpëtimin e ekipit granata nga rënia në Kategori. Drejtori Sportiv i Lazios, Igli Tare, është dënuar me përjashtim nga aktiviteti deri më 31 maj, si dhe me një gjobë prej 5 000.00 eurosh. Drejtori shqiptar është dënuar për shkak se në fundin e pjesës së parë ka hyrë në dhomat e zhveshjeve, duke u ballafaquar me gjyqtarin në mënyrë kërcënuese dhe duke mos e lejuar që të futet. Tare është përsëritës me veprime të tilla ndaj dhe ka marrë këtë dënim.

Dzeko, afër Barcelonës

Sulmuesi Edin Dzeko është afër largimit nga Roma, ndërsa mediat në Itali e drejtojnë atë në Spanjë, te skuadra e Barcelonës. Dzeko pritet që javën e ardhshme të ulet me drejtuesit e AS Roma, që të diskutojë rreth qëndrimit në "Olimpico" edhe pse ditë më parë trajneri Jose Mourinho ka deklaruar se nuk do të mbështetet te sulmuesi boshnjak në edicionin e ri. Sulmuesi boshnjak iu bashkua Romës në vitin 2015, ndërsa në fanellën e skuadrës nga kryeqendra e Italisë zhvilloi 256 ndeshje dhe shënoi 118 gola.

Zbulohet çmimi i biletave për finalen e Ligës së Kampionëve

Më 29 maj do të zhvillohet ndeshja finale në mes të Chelseas dhe Manchester Cityt në stadiumin e Portos "Estadio do Dragao". Në këtë takim është paraparë edhe rikthimi i tifozëve për herë të parë në këtë stinor të Ligës së Kampionëve, pasi një gjë e tillë nuk ka qenë e mundur si shkak i rregullave Covid-19. Klubi i Chelseat ka njoftuar përmes llogarisë zyrtare mbi çmimin e biletave, ku në radhën e parë çmimi do të jetë afro 600 euro. Në radhën e dytë në stadium, çmimi për një biletë do të kushtojë rreth 440 euro, derisa më i lirë do të jetë ai në shkallët e larta të stadiumit (69 euro). Çmimet e biletave janë mësuar edhe për personat të cilët gjenden në karrige me rrota, ku do të jetë 69 euro. Skuadra e Chelsea do të ketë 5 800 biletë, derisa shifër të njëjtë do të ketë edhe Manchester City.

Bach: 75 % e sportistëve do të jenë vaksinuar para Olimpiadës

Tokio, 19 maj - Presidenti i Komitetit Olimpik Ndërkombëtar (IOC), Thomas Bach, ka deklaruar se po bën maksimumin që Olimpiada që nis më 23 korrik në Tokio të jetë e sigurt. Për këtë arsye ai shtoi se po bëhet një punë e

madhe për t'i vaksinuar sportistët dhe stafet olimpikë që do të mbërrin në Japoni. "IOC është angazhuar maksimalisht për të organizuar një olimpiadë të sigurt dhe për të garantuar që populli japonez të jetë i sigurt. Aktualisht, 75 %

e sportistëve dhe stafeve janë të vaksinuar apo do të vaksinohen deri më 23 korrik, pasi kemi marrë konfirmimin nga vendet përkatëse", ka thënë Bach. Numri një i olimpizmit ndërkombëtar më tej ka shtuar:

"Olimpiada do të organizohet, pasi populli japonez ka vendosmërinë dhe kapacitetin për t'u rezistuar problemeve. E gjithë bota do t'i jetë mirënjohëse popullit japonez dhe virtyeteve të tij. Do të shihemi në Tokio më 23 korrik".



Low zbardh listën për Evropian, rikthehen Mulleri dhe Hummelsi

Munchen, 19 maj - Trajneri Joachim Low ka publikuar listën e lojtarëve të grumbulluar për "Euro 2020". E veçanta e listës janë rikthimet e Thomas Mullerit dhe Mats Hummelsit, sulmuesit të Bayern Munchenit dhe kapitenit të Borussia Dortmundit. 31-vjeçari bavarez nuk luan me "Pancerat" prej momentit që përfundoi Botërori "Rusi 2018". Trajneri vendosi ta rinovojë grupin pas paraqitjes zhgënjyese në Kupën e Botës. Emra si Thomas Muller, Jerome Boateng dhe Mats Hummels u "përfshuan", por Low ka vendosur të tërhiqet falë formës së mirë sportive që po kalon lojtari i



Bayern Munchenit. 26 lojtarë kanë marrë ftesën e katër herë kampionëve të botës. Në listë edhe Jamal Musiala, talenti 18-vjeçar i Bayernit, i cili këtë sezon ka shënuar shtatë gola.

Lista e plotë e futbollistëve:

Portierë: Bernd Leno, Manuel Neuer, Kevin Trapp

Mbrojtës: Matthias Ginter, Robin Gosens, Christian Gunter, Marcel Halstenberg, Mats Hummels, Lukas Klostermann, Robin Koch, Antonio Rudiger, Niklas Süle

Mesfushorë/Sulmues: Emre Can, Serge Gnabry, Leon Goretzka, Ilkay Gundogan, Kai Havertz, Jonas Hofmann, Joshua Kimmich, Toni Kroos, Thomas Muller, Jamal Musiala, Florian Neuhaus, Leroy Sane, Kevin Volland, Timo Werner.

Celticsi kualifikohet në fazën finale të 'play-off'-it, Pacersi kalon pengesën e parë

Washington, 19 maj - Faza e parë "play-off" e NBA-s nisi me dy fitore vendase në Konferencën e Lindjes. Boston Celticsi siguroi kalimin në fazën finale të "play-off"-it teksa e mbylli sezonin e rregullit si skuadra e pozicionuar në vendin e shtatë pasi fitoi duelin direkt ndaj Washington Wizardsit në "TD Garden" me rezultatin e thellë 118-100. Një ndeshje e ekuilibruar në pjesën e parë me Washingtonin që shkoi në pushim në avantazhin e dy pikëve. Por skuadra kryeqytetase u dorëzua pa kushte në fraksionin e dytë të lojës të cilin e humbi me 20 pikë diferencë, për meritë edhe të Jason Tatunit i cili ishte thjesht monstruoze duke e mbyllur ndeshjen me 50 pikë, 8 rebounde dhe 4 asistime, raporton "Supersport". Një dorë në këtë sukses të rëndësishëm Bostonit ia



dha edhe Kemba Walker, autor i 29 pikëve, ndërkohë që në krahun tjetër 22 pikët e Bradley Bealit dhe 20 të Rusell Westbrookut ishin të pamjaftueshme që Wizardsi të regjistronte një rezultat pozitiv në këtë sfidë. Bostoni pas këtij triumfi tashmë do të sfidojë në raundin çerekfinal në Lindje, Brooklyn Nets,

një nga skuadrat favorite për titullin në këtë sezon, ndërkohë Washingtoni, pavarësisht prej humbjes, do të ketë edhe një shans tjetër për të qenë pjesë e fazës finale të "play-off"-it pasi do të përballet në betejën për vendin e 8-të me Indiana Pacersin. Skuadra nga Indianapolis bëri një paraqitje mbresëlënëse në sfidën ndaj Charlotte Hornetsit duke fituar me rezultatin e thellë 144-117. Indiana zgjidhi gjithçka që në pjesën e parë, fraksion të cilin e mbylli në avantazhin e 24 pikëve. Kanadezi Brisset me 23 pikë dhe McDermott me 21 pikë ishin dy basketbollistët më të mirë mbi parket për Indianën që tashmë duhet t'i masë forcat me Washingtonin në transfertë për ta siguruar biletën për në fazën finale "play-off" aty ku e pret Philadelphia 76ers.

SHKURT

Xavi refuzon ofertën e Dortmundit

Gazeta spanjolle "AS" raporton se ish-mesfushori i Barcelonës, Xavi Hernandez, ka refuzuar ofertën për t'u ulur në stolin e Borussia Dortmundit në kohën që këta të fundit janë në kërkim të një trajneri. Gjithashtu, gazeta shkruan se Xavi ka refuzuar edhe një ofertë nga federata braziliane për t'u afruar në kombëtare si ndihmës i trajnerit Tite. Ish-mesfushori aktualisht drejton skuadrën e Al-Sadit në Katar dhe shihet si pasardhësi i Roland Koemane në stolin e Barcelonës, por disa ditë më parë klubi nga Katari rinovoi kontratën edhe për dy vjet të tjera me ish-blaugranasin.

Griezmanni mund të rikthehet në Atletico

Sulmuesi i Francës, Antoine Griezmann, në afatin kalimtar të verës mund të largohet nga Barcelona. Mediat në Spanjë kanë raportuar se sulmuesi francez mund të rikthehet në Atletico Madrid. Në këtë marrëveshje mund të përfshihet Joao Felix, i cili do t'i bashkojë Barcelonës. 30-vjeçari është paraqitur për Atletico në 180 ndeshje dhe kishte shënuar 94 gola.

Seoane emërohet trajner i Leverkusenit

Bayer Leverkusen ka emëruar trajnerin e ri për sezonin e ardhshëm. Bëhet fjalë për Gerardo Seoane, që drejton Young Boys prej vitit 2018, ia ka dalë të fitojë tre tituj kampionë radhazi me skuadrën helvete dhe më 1 korrik do ta nisë aventurën e re te Leverkuseni. 43-vjeçari zviceran ka firmosur një kontratë deri në verën e vitit 2024, por tashmë do të nisë një përvojë të re në Bundesligë.

Leclerc synon podiumin në Montekarlo

Charles Leclerc synon ta thyejë tabunë e Hamiltonit e Verstappenit, që kanë dubluar mes tyre e triumfu në katër garat e para sezonale. Këtë fundjavë garohet në pistën e Montekarlos, një pistë e ngushtë qytetase, ku të papriturat mund të ndodhin në çdo çast. Kjo garë ka dhuruar shpesh surpriza, me pilotë që kanë dalë fitues falë rrethanave të krijuara gjatë garës. "Është një pistë e veçantë, që të gjithë pilotët e duan. Për mua kjo është gara e shtëpisë dhe dua të bëj një paraqitje të mirë, të dueloj për fitoren. Kjo është një pistë ku Ferrari mund ta bëjë diferencën, duke qenë se nuk ka pjesë të gjata dhe parakalimet janë të vështira. Në rast se situatat janë në favorin tonë, mund ta marrim podiumin apo diçka më shumë", ka thënë Leclerc.

Barça hyn në kredi për t'i paguar pagat e lojtarëve

Barcelona ka siguruar një kredi prej 500 milionë eurosh nga Goldman Sachs për shkak se klubi u ka borxh lojtarëve pagat. Sipas raportimit të ESPN-së, 100 milionë euro do të lëshohen menjëherë për t'i shlyer

borxhet ndaj futbollistëve. Barça gjatë pandemisë ka pasur shumë probleme financiare. Presidenti Joan Laporta duket se ka qenë çelësi që ekipi ka siguruar këtë kredi prej 500 milionë eurosh nga banka e investimeve

amerikane, Goldman Sachs. Sipas llogaritjes, borxhi i "blaugranave" është 1.2 miliard euro. Siç raporton ESPN, situata me pagat e papaguara ishte aq e keqe sa që lojtarët e skuadrës ishin përgatitur për ta dërguar këtë

çështje në Federatën e Futbollit të Spanjës. Barcelona ishte pajtuar me futbollistët që t'i shtyjë pagat e tyre gjatë pandemisë, por edhe gjatë kësaj kohe ata dolën jashtë premtimit të tyre.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, shpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e drejtorit të Agjencisë Kundër Korrupsionit

Agjencia Kundër Korrupsionit është organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për luftimin dhe për parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

Kandidati për drejtor të Agjencisë duhet t'i plotësojë kushtet e përcaktuara në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L- 159 për Agjencinë Kundër Korrupsionit, si vijon:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës dhe të ketë vendbanim të përhershëm në Kosovë;
- Të ketë së paku diplomë universiteti katërvjeçar ose master;
- Të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale;
- Të ketë integritet të lartë moral;
- Të ketë së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune profesionale.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografia);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURRIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 03.06.2021, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org
 Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 211-182, 038 211-648 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor direktora Agencije za borbu protiv korupcije

Agjencia za borbu protiv korupcije je nezavisno telo, specializovano za sprovođenje državnih politika i za sprečavanje korupcije na Kosovu.

Kandidat za direktora Agencije treba ispuniti uslove predviđene u članu 8. Zakona br. 03/L- 159 o Agenciji za borbu protiv korupcije, kao u nastavku:

- Mora biti državljanin Republike Kosovo i mora imati stalno boravište na Kosovu;
- Mora imati najmanje univerzitetsku diplomu od četiri godina ili master studije;
- Da ne bude kažnjen za krivično delo;
- Mora imati visoki moralni integritet;
- Mora imati najmanje pet (5.) godina profesionalnog radnog iskustva.

Prijavi se treba priložiti sledeća prateća dokumentacija:

- Dokaz o školskoj i profesionalnoj spremi;
- Curriculum Vitae (CV - autobiografija);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije kažnjen za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 03.06.2021. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u
Elektronskom obliku: internet-stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038 211-182, 038 211-648 i 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE
 REGIONAL WASTE COMPANY
 REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel.+381(0)390/321 588
 +381(0)390/324 034
www.cabrati.com
 e-mail. info@cabrati.com
 Gjakovë - Gjakova

K.R.M. "ÇABRATI"

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212), nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.7/2017, dhe Vendimin Nr.52/2021 me Nr. Protokolli 853 i datës 18.05.2021, në përputhje edhe me Organogram dhe Rregulloren "Për Përshkrimin e Detyrave të Punës dhe Përgjegjësit në Punë", Nenit 5 të "Rregullores Për Pagat" si dhe kompetencave të përcaktuara në Ligjin për Ndërmarrje Publike në fuqi, nenit 25 të Statutit të K.R.M. "Çabrati" Sh.A, Gjakovë, Kryeshefi Ekzekutiv me datë 20.05.2021, vendosi të shpallë:

KONKURS

Pozita:	Mekanik
Numri:	1 / një/
Kohëzgjatja:	Kohë të caktuar
I përgjigjet:	Mekanikut Kryesor dhe Koordinatorit të Autoparkut
Vendi:	Gjakovë.

Detyrat dhe Përgjegjësit:

- Riparon automjetet e autoparkut, kontrollon kushtet në tersi të parkut të automjeteve;
- Bënë mirëmbajtjen e pastërtisë së Punëtorisë në Autopark;
- Bënë mirëmbajtjen e pajisjeve dhe mjeteve të punës në Punëtori;
- Përgjigjet dhe raporton te Udhëheqësi i punëtorisë – Kryemekaniku.
- Riparimin e aseteve nga fusha e saldimit.
- Përbushë detyra tjera nga zona e tij e përgjegjësisë sipas kërkesave të Udhëheqësit dhe nevojës së procesit të punës dhe interesit të Ndërmarrjes

Paga: Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

Kushtet e përgjithshme:

- Të ketë të kryer shkollën e mesme;
- Të ketë së paku një (1) vit përvojë pune;

Kushtet e veçanta:

- E domosdoshme të posedoj njohuri nga profesioni,
- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj).

Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Dëshminë që posedon njohuri nga profesioni,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Kopja e dokumentit të identifikimit.

Konkursi është i hapur **15** (pesëmbëdhjetë) ditë, nga data **20.05.2021** deri me datën **03.06. 2021**, në orën **16:00**.

Kërkesa me dokumentacionin e kërkuar, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek menaxheri i Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë.

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së testit dhe intervistës.



CONTRACT AWARD NOTICE

Supplies

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 18/05/2021

Procurement No	Equipment	001	2021	121
----------------	-----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"	
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana U1/1	
Town: Prishtina	Postal code: 10000 Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 044-128-277
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-865
Internet address (if applicable):	www.matherteresasociety.org

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:

Supplies with Bag Equipment for 220 Beneficiaries-Returnees

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance

(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

<input checked="" type="checkbox"/> Supplies
Main place of performance All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract

Supplies with Bag Equipment for 220 Beneficiaries-Returnees

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

93.000.000.-8

Standard Form "Contract Award Notice"

1

II.1.6) Division into lots	YES	<input checked="" type="checkbox"/>
II.1.7) Contract value: 220,367.40		

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

Open

III.2) AWARD CRITERIA

<input checked="" type="checkbox"/> Lowest price
--

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat S IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award	18/05/2021
IV.2) Intended date of contract signing	01/06/2021
IV.3) Number of received tenders	5
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded	
Official name:	"General Supply and Logistics" Sh.p.k.
Postal address:	10000 Prishtinë
Town: Prishtinë	Postal code: 10000 Country: Kosovo
URL (if applicable):	
Contact point(s): Besfort Hyseni	Email: generalsupplyandlogistics@gmail.com
Telephone: 045321797	Fax:

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 220,367.20 Euro

Responsive tender with lowest price: 220,367.20 Euro
Responsive tender with highest price: 242,611.60 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted	No	<input type="checkbox"/>
--	----	--------------------------

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract award notice.

Standard Form "Contract Award Notice"

2



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Deklaroni të ardhurat dhe paguani tatimin!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, se janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë tatimet dhe Kontributet Pensionale në mënyrë reale dhe në kohë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin tatimor.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te personat, të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimin dhe Kontributet Pensionale.

Për personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, të cilët nuk deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimet dhe Kontributet Pensionale, ATK do të ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Andaj, ATK, u bënë thirrje të gjithë personave që të deklarojnë të ardhurat e krijuara apo të korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tatimore, kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimim me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

Pagesa e tatimit, siguron qëndrueshmëri të ekonomisë në vend!

Administrata Tatimore e Kosovës

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Eldri Com", Sh.p.k. Malishevë, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në Zatriq, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 10.06.2021 në ora 11:00 në Lokalet e Kompanisë "Eldri Com", Sh.p.k. Malishevë afër fashatit Zatriq do të organizohet debat publik nga Kompania "Eldri Com", Sh.p.k. Malishevë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e gurit gëlqeror në Zatriq, Malishevë

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Platforma ZOOM Linku:

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=UmQvcFNUNGQzRVFOM3RnU0d2K283Zz09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Eldri Com", Sh.p.k. Malishevë, shfrytëzimin e gurit gëlqeror në Zatriq, Malishevë

https://mea.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS


TAVERNA

Tel: +377 45 400 156
+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Lirim Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi" Prizren.
- ▶ Diar Xhelovci shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu "Hatmaxhe" Hatmaxhe.
- ▶ Myvedete Hoxha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Dy Dëshmorët" Piranë.
- ▶ Ilirida D.P.T shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 80189222
- ▶ Vjollca Shabani shpalle te humbur diplomën e kolegjit AAB,drejtimi " Kujdesi për mireqenie sociale".
- ▶ Milaim Hi. Ramadani shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 70901641.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
06-Nr-718
Me datë: 31.03.2021

Në bazë të nenit 8. të paragrafit 1 dhe 2 të Ligjit të punës Nr- 03/L-212, nenit 4 par.2 të Udhëzimit Administrativ(MPMS)nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Autorizimit të Kryetarit Komunës,01-Nr.016-18400 të datës 18.03.2021, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë :

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

- Një Mjek/e Specialist/e të Peditriisë.
- Kohëzgjatja e kontratës : Sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212/Për periudhë të pacaktuar (puna provuese 6 muaj).
- Orari i punës : 40 orë në javë.
- Koficienti: Gr./H-Doktor-specialist H-659/1
- Vendi i punës: QKMF- Suharekë
- Mbikëqyrja: Drejtori i QKMF-së

NJE (1) SPECIALIST | PEDIATRISË NE QKMF-Suharekë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheq dhe organizon punën në njësinë konsultative —pediatrike në QKMF.
- Mban përgjegjësi për kontrollimin,hulumtimin,diagnostikimin,trajtimin (përcjellje të vazhdueshme të pacientit,po asht është përgjegjës për saktësinë e të dhënave të regjistruara në dokumentacionin dhe në evidence shëndetësore gjatë ofrimit shërbimeve shëndetësore që përmbajnë të dhëna për identitetin personal të banorit,diagnozën dhe trajtimin dhe udhëzon infermieret për trajtim
- I përgjigjet situatave emergjente dhe gjendjeve të jashtëzakonshme në cdo kohë dhe kërkon mbështetje në rast të situatave emergjente,
- Bënë kontrollime specialistike —pediatrike te pacientëve me udhëzim të mjekut.
- Merr pjesë në mbledhjet të cilat i fton shefi i mjekësisë familjare ose Drejtori e në të cilat shqyrtohen tema të ndryshme profesionale apo çështje organizative
- Peditri duhet të mer pjesë në edukimin e vazhdueshëm profesional
- Eshtë përgjegjës për të zbatuar detyrat sipas ligjeve në fuqi dhe akteve nënligjore te institucionit shëndetësor që janë Statuti | QKMF-se .aktvendimet .urdhësesat tjera lëshuar nga DSHMS-ja.
 - Është e obliguar të respektohet kodi i veshjës.

- Kryen edhe punë tjera në kuadër të profesionit fushë veprimtaria e tij me kërkesë të Drejtorit të QKMF-se.
- Për punën i përgjigjet shefit të mjekëve. Drejtorit të QKMF-se dhe Drejtorit të DSHMS-se.

Kushtet dhe kriteret :

- Fakulteti i Mjekësisë — Drejtimi i Peditriisë
- Licenca nga Ministria e Shëndetësisë
- Certifikata Shëndetësore.
- Certifikata që nuk është nën hetime.
- Vërtetimi nga Policia që nuk është nën hetime
- Letërnjoftimi kopje


Aftësitë:

- Të ketë aftësi komunikimi.
- Të ketë aftësi për udhëheqjen e punës i /e pavarur duke respektuar Ligjin si dhe etikën.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në tabelën e shpalljeve

- Fletëaplikacionet merren në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Suharekë , adresa te parku i qytetit kati III .

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe M.Sociale :
Ma.Sc. Besa KUQI



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

Direkcija za zdravstvo i socijalnu zaštitu

06-Br-718

Po datumu: 31.03.2021

U skladu sa članom 8. stava 1. i 2. Zakona o radu br. 03 / L-212, članom 4. stav 2. Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju procedure konkursa postupka u javnom sektoru, Ovlašćenje predsednika opštine, br. 0116-18400 od 18.03.2021, Direkcija za zdravstvo i socijalnu zaštitu objavljuje:

KONKURS

Za popunu radnog mesta

- Jedan lekar-Specialista za pedijatriju.
- Trajanje ugovora: Prema Zakonu o radu br. 03 / L-212 / na neodređeno vreme (probni rad 6 meseca).
- Radno vreme: 40 sati nedeljno.
- Koficijenti: Gr./H-Doktor-specijalista H-659/1

Mesto rada: OCPZ- Suva Reka

- Nadzor: direktor OCPZ

JEDAN (1) SPECIJALIST A| PEDIJATRIJE U OCPZ -Suva Reka

Dužnosti i odgovornosti:

- Upravlja i organizuje rad u konsultativno-pedijatrijskoj jedinici u OCPZ.
- Odgovara za kontrolu, istraživanje, dijagnozu, lečenje (kontinuirano praćenje pacijenta, dogovara za tačnost podataka zabeleženih u dokumentaciji i zdravstvenim kartonima prilikom pružanja zdravstvenih usluga koje sadrže podatke o ličnom identitetu stanovnika, dijagnozi i lečenju i upućuje medicinske sestre na lečenje
- U svakom trenutku reaguje na vanredne i hitne slučajeve i traži podršku u slučaju nužde,
- Izvršiti specijalističko-pedijatrijske preglede pacijenata prema uputstvima lekara.
- Učestvuje na sastancima koje saziva šef porodične medicine ili direktor na kojima se raspravlja o različitim profesionalnim temama ili organizacionim pitanjima
- Pedijatar mora učestvovati u kontinuiranom profesionalnom obrazovanju
- Odgovoran je za sprovođenje dužnosti u skladu sa zakonima na snazi i podzakonskim aktima zdravstvene ustanove koji su statut | OCPZ .odluke .drugi nalozi koje izdaje DZSZ.
- Obavezan je poštovati pravila odjevanja.
- Obavlja druge poslove iz oblasti struke svoje delatnosti na zahtev direktora OCPZ.
- Za rad odgovoran glavnom lekaru. Direktor OCPZ i direktor DZSZ

Uslovi i kriterijumi:

- Medicinski fakultet – Smer za pedijatriju
- Licenca Ministarstva zdravlja
- Uvjerenje o zdravstvenom stanju.
- Potvrda da nije pod istragom.
- Potvrda policije da nije pod istragom
- Fotokopija lične karte

Veštine:

- Da ima veštine komunikacije.
- Da imaju sposobnost samostalnog, nezavisnog vođenja posla poštujući zakon i etiku.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u medijima i na oglasnoj table

- Obrasci za prijavu se dobijaju u Direkciji za zdravstvo i socijalnu zaštitu - Suva Reka, adresa gradski park, Sprat- III.

Direktor Direkcije za zdravstvo i socijalnu zaštitu
Mas.Sc. Besa KUQI